

Adresa: Bl

Nr. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

V E N D I M

Nr.____, Datë _____

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MEMALIAJ MBI AUDITIMIN E RREGULLSHMËRISË për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Memaliaj, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit. Për periudhën objekt i auditimit u konstatuan dhe të meta e dobësi me pasoja financiare në drejtim të zbatimit të kontratave për punë publike.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë të ushtruar në Bashkinë Memaliaj, sipas programit të auditimit nr. 686/1, datë 12.06.2018 ndryshuar me nr. 686/2, datë 02.07.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri në 31.12.2017 dhe për ish-komunat nga data 01.01.2013 deri në 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Buxhetet janë miratuar jashtë afateve ligjore, pasi duhej të miratoheshin para mbylljes së viteve para ardhës. Është respektuar limiti i shpenzimeve mujore në masën 1/12 e shpenzimeve të viteve të mëparshme sipas kërkesave të ligjit të buxhetit, por miratimi me

vonesë i buxheteve, për vitin 2016 sipas VKB nr. 8, datë 18.03.2016 dhe për vitin 2017 me VKB nr.6, datë 10.03.2017 është në kundërshtim me nenin 32,“Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor” të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008,“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Brenda muajit Nëntor të vitit buxhetor, kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore të gjitha niveleve paraqesin për miratim buxhetet e këshillave të tyre.Këshilli i qeverisjes vendore brenda datës 31 Dhjetor,miratton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vendor”.

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj të merren masa për përgatitjen e tregueseve të buxhetit për vitet buxhetore përpara fillimit të viteve ushtrimore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Treguesit e PBA për vitet 2017-2019, janë përgatitur nga sektorët dhe zyrat e bashkisë brenda afateve ligjore dhe të analizuar për të ardhurat dhe shpenzimet, por nga nëpunësi urdhërues nuk është ngritur grup pune për hartimin e treguesve të PBA sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4/1, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” si dhe nuk është miratuar kalendari dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik.

2.1 Rekomandimi: Nga nëpunësi urdhërues të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik i cili të kryesohet nga nëpunësi urdhërues dhe të përfshihen të gjithë drejtuesit kryesor të Bashkisë Memaliaj. Njëkohësisht rast pas rasti të hartohet kalendari i veprimeve për hartimin e treguesve të PBA.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë nr. 202 “Studime e kërkime” është mbartur nga viti 2015 vlera 2,595,600 lekë, që ju përket ish- Komunës Memaliaj Fshat vlera 1,602,000 lekë; ish-Komuna Krahës vlera 619,600 lekë dhe ish- Komuna Qesarat, vlera 374,000 lekë. Pozicioni financiar analitikisht përbëhet nga projekte që ju përkasin objekteve në fushën e ndërtimeve. Edhe nga Bashkia Memaliaj është ndjekur e njëjta praktikë duke i mbartur vlerën e projekteve edhe pas marrjes në dorëzim të objekteve, ku në bilancin e vitit 2017, llogaria nr. 202,“Studime e kërkime”, ka pozicion financiar në vlerën 3,920,023 lekë. Kjo praktikë e ndjekur nga bashkia nuk është në përputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” pika C “Të ndryshme”, pasi vlera e projekteve i kalon objektit të përfunduar.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës me specialistin e Urbanistikës të kryej rakordimet për saktësimin e projekteve mbështetur në të dhënat e bilancit kontabël të vitit 2017, për vlerën 3,920,023 lekë. Pas saktësimit të projekteve ndërtimore që janë vënë në zbatim të kryhet veprimi kontabël duke kredituar llogarinë nr. 202, “Studime e kërkime” dhe duke debituar llogaritë përkatëse aktiveve të qëndrueshme afatgjata (*Në mënyrë analitike sipas projekteve*).

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 15, datë 25.05.2017, janë transferuar 16 ujësjellës në vlerë 43,047,908 lekë dhe 6 rrjete dytësore KUZ të njësive administrative në vlerë 32,012,430 lekë pranë (Ujësjellës dhe KUZ) në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, në vlerën 75,060,338 lekë kurse, në pasqyrën nr.6, ” Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (Vlera) bruto”, figuron në vlerën 59,796,846 lekë me diferencë 15,263,492 lekë më pak në pasqyrën e bilancit.

4.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës së Bashkisë Memaliaj të merren masa për saktësimin e vlerave të ujësjellësve dhe të rrjeteve dytësore KUZ transferuar në Ndërmarrjen e Ujësjellës- Kanalizime Tepelenë për sa nuk rakordon vlera 15,263,492 lekë si diferencë midis vlerës së transferuar dhe pasqyrës financiare nr. 6, ”Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (Vlera) bruto”.

Brenda datës 31.12.2018

5. Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i inventarizimit të pasurisë të vitit 2015 janë vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit 5 automjete me vlerë 3,102,750 lekë. Nuk kanë përfunduar procedurat e tjetërsimit (nxjerrjes jashtë përdorimit), për arsye të detyrimeve të papaguara të taksave vjetore të automjeteve. (Aktualisht janë falur detyrimet e Taksës vjetore të automjeteve sipas Ligjit Nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen / shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në dogane, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes / shuarjes së detyrimeve tatimore). Mjetet administrohen me inventarë në oborrin e bashkisë por në kontabilitet nuk janë mbajtur në llogarinë përkatëse nr. 24 ”Aktive të dëmtuara”. Për vitet 2015 - 2017, nuk janë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit aktive afatgjata e afatshkurtër përveç mjeteve të transportit.

5.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata e afatshkurtër për të nxjerrë jashtë përdorimit për vitin 2018 si dhe të merren masa për tjetërsimin e 5 (pesë) automjeteve të vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit që nga viti 2015, në vlerën 3,102,750 lekë.

Brenda datës 31.12.2018

6. Gjetje nga auditimi: Nga njësitë e shkrira nuk është ndjekur i njëjti standard në paraqitjen e pozicioneve financiare për kundra partinë e llogarisë debitorë. Nga njësitë e shkrira nuk është azhurnuar libri i madh apo centralizatori, dokumentacion që duhej të shoqëronte bilancet. Këto parregullsi bien në kundërshtim me rregullimet e parashikuara në UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” si dhe Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Projektit “STAR”, komuniteti i donatorëve UNDP Albania, fond multi - donatorë nën menaxhimin e UNDP (Program i Kombeve të Bashkuara) i njohur si projekti në mbështetje të reformës territoriale administrative (STAR) është krijuar me qëllim për të ofruar mbështetje koherente teknike, operationale dhe logjistike ndaj procesit të reformës nëpërmjet Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)– institucion qendror përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e reformës. Nga mungesa e bashkëpunimit të ekipit me Bashkinë

Memaliaj bilancet e ish- komunave janë miratuar me pasaktësi në pozicionet financiare të llogarive kryesore (aktivi dhe pasivi i bilanceve) si më poshtë:

(në lekë)

Nr.llog	Mem/ Fshat	Buz	Krahës	Qesarat	Luftinjë
466	1,657,629	75,817	1,408,006	807,315	898,061
467	191,476	740,016	628,225	6,072,505	300,000
468(Total)	1,949,105	815,833	2,036,231	8,591,348	1,198,061
85	1,930,152	4247398	4447251	667,0258	1,922,985
4342	1,930,152	4,247,398	4,447,251	8,591,348	1,922,985
4341	1,930,152	4,247,398	4,447,251	6;670;258	1,922,985

Gabimisht është debituar llogaria nr. 468, "Debitor në persona " duke kredituar llogarinë nr. 466 "Vlera në ruajtje" dhe llogarinë nr. 467 "Kreditor të tjerë". Në vend të llogarisë nr. 468, është debituar llogaria nr. 4342 "Të tjera operacione me shtetin debitor(përmban analizën e llogarisë nr. 468). E njëjta praktikë është ndjekur dhe nga bashkia (Të ndikuar nga ekipi i Programit STAR 1) në vitet në vazhdim dhe, në bilancin e vitit 2017, janë paraqitur pozicione të gabuara të llogarive e konkretisht:

Nr.llogarisë	Emërtimi i llogarive (viti 2017)	Lekë
466	Mjete në ruajtje	11,077,297
467	Kreditor të ndryshëm	52,362,066
468	Debitor ne persona	63,439,363
520	Disponibilitete në thesar	81,874,737
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	31,126,099
4341	Të tjera operacione me shtetin kreditor	31,126,099
85	Rezultati	81,874,737

6.1 Rekomandimi: Të sistemohen pozicionet financiare të gabuara të trashëguar nga ish – Komunat dhe nga bashkia të mbartur në bilancin e vitit 2017, të anulohet teprica e trashëguar në llogarinë nr. 468 "Debitorë" për vlerën 63,439,363 lekë duke debituar llogarinë nr. 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme". Të kreditohet llogaria nr. 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor) dhe të debitohet llogaria nr. 468 "Debitorë në persona" për vlerën 31,126,099 lekë. Të debitohet llogaria nr. 4341 "Të tjera operacione me shtetin kreditor" dhe të kreditohet llogari nr. 475 "të ardhura për tu arkëtuar" në vlerën 31,126,099. Të ndryshohet rezultati i vitit 2017, për sa është paraqitur më i lartë për pozicionin financiar të llogarisë nr. 466 "Vlera në ruajtje" për shumën 11,077,297 lekë.

Brenda datës 31.12.2018

7. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e vitit 2016 e 2017 nuk janë paraqitur vlera në llogarinë nr. 231 "Shpenzime në proces" edhe pse kanë rezultuar detyrime të pa shlyera në llogarinë nr. 467 "Kreditor të tjerë" për fatura të pa likuiduara që ju përkasin investimeve.

7.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të merren masa për kontabilizimin e faturave para se të kryhet likuidimi i tyre ose paralelisht me likuidimin për pasqyrim të saktë të detyrimeve ndaj të tetëve në kontabilitetin e bashkisë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake është përfshirë si strukturë në Agjencinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar). Për vitin 2017, janë marrë në punë 2 (dy) punonjës mbështetur në kodin e punës ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996. Rezulton se nuk janë zhvilluar procedura në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar).

8.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në cilësinë e nëpunësit urdhërues, të merren masa për organizimin e Policisë Bashkiake në strukturë të veçantë në varësi të nivelit të lartë drejtues.

Brenda datës 31.12.2018

9. Gjetje nga auditimi: Nuk ka rakordim dy palesh nga Agjencia e Inspektimit të Territorit dhe Taksa-Tatime me Drejtorinë e Financës në mbyllje të viteve ushtrimore për dinamikën e debitorëve. Në rastet e shlyerjeve të prapambetura nuk është kredituar llogaria debitorë (sipas analizës) por janë kredituar të ardhurat dhe nuk ka saktësi të plotë lista e detyrimeve sipas të dhënave që disponon Agjencia e Taksave e Tarifave. Sipas të dhënave të regjistrave kanë detyrime të pashlyera nga taksat dhe tarifave vendore 1,648 persona në vlerën 8,696,026 lekë. Në këtë agjenci u gjetën të pa regjistruar në kontabilitet 72 persona në vlerën 1,817,159 lekë.

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Agjencia e Taksave e Tarifave dhe Kontrollit të Territorit të merren masa për kalimin në kontabilitet të detyrimeve në vlerën 1,817,159 që ju përkasin 72 rasteve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Është përfshirë në strukturën e Agjencisë së Taksave dhe Tarifave Vendore “Specialist i Apelimit Tatimorë”, por nga verifikimi i dokumentacionit që administrohet në bashki për periudhën e audituar (2016 e 2017), nuk është bërë asnjë ankesë dhe nëpunësi që përmbush këtë funksion, referuar rregullores së brendshme, nuk është i zënë me punë plotësisht.

10.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj të merren masa që brenda strukturës nëpunësi i apelimit tatimor të ngarkohet dhe me detyra të tjera duke përshtetur dhe proceset dhe operacionet e punës që do të kryej përveç këtij funksionit që ka aktualisht.

Brenda datës 31.12.2018

11. Gjetje nga auditimi: Pronat e transferuara nga Pushteti Qendrorë në ish- Komunat para reformës administrative nuk janë regjistruar në ZVRPP dhe nuk janë përditësuar regjistrat. Nuk janë zbatuar pikat 73,74,75 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.11.2010 “ Për menaxhimin e aktiveve në sektorin Publik” dhe pikat 2,5,6,7,8,9 a-b-c të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nga ish-drejtuesit e ish-Komunave (Para reformës administrative) dhe strukturat e Bashkisë Memaliaj (Pas reformës administrative), nuk janë kryer inventarë për objektet social kulturore, për gjendjen fizike, funksionale, administrimin. Nga bashkia nuk janë hartuar regjistra të veçantë dhe nuk janë kryer vlerësimet për përfshirjen

në kontabilitet të trojeve, ndërtesave etj. Bilancet e ish- Komunave nuk janë shoqëruar me listën e inventarëve të kaluar në pronësi të Komunave, për gjendjen fizike, administrimin dhe problemet e dala për statusin juridik të tyre.

11.1 Rekomandimi: Nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të merren masa për krijimin e regjistrit të pronave dhe të vlerësohen me ekspert trojet dhe ndërtesat e kaluara në pronësi të Bashkisë Memaliaj dhe të ish-komunave për përfshirjen e tyre në bilancin kontabël dhe regjistrimin në ZVRPP.

Brenda datës 31.12.2018

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Memaliaj nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike me objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezultojnë se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Memaliaj nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësisve të përshkuara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezultojnë se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

- a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.
- b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale, si objektivi prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

12.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

Brenda datës 31.12.2018

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe, mbështetur në nenet 98-102,

të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe, pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, pas vlerësimit të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **6,330,858 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugët e njësisë administrative të Bashkisë Memaliaj*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **53,269 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 718/8 prot. datë 03.10.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Memaliaj dhe OE [REDACTED] sh.p.k.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **53,269 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik [REDACTED] sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 718/8 prot. datë 03.10.2016 me objekt “*Rikonstruksion rrugët e njësisë administrative të Bashkisë Memaliaj*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktik.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemim e asfaltim rruga Memaliaj Fshat, Bashkia Memaliaj*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **119,746 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 642/11 prot. datë 31.08.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Memaliaj dhe BOE [REDACTED] shpk.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **119,746 lekë pa tvsh** nga BOE [REDACTED] shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 642/11 prot. datë 31.08.2017 me objekt “*Sistemim e asfaltim rruga Memaliaj Fshat, Bashkia Memaliaj*”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktik.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ansambli Arkitektonik i Sheshit Minatori Memaliaj*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **6,157,843 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 314/38 dt.12.07.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Memaliaj dhe BOE [REDACTED] shpk.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Memaliaj të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,157,843 lekë pa tvsh** nga BOE [REDAKTUAR] shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 314/38 dt.12.07.2016 me objekt “Ansamblu Arkitektonik i Sheshit Minatori Memaliaj”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktik.

Menjëherë

B/1. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në ish-komunën Luftinjë gjatë vitit 2013, u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt “KUZ fshati Izvor “ nuk është vepruar në përputhje të plotë me nenin 2, “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ndër OE të skualifikuar, është skualifikuar OE [REDAKTUAR] SHPK, me ofertë ekonomike në shumën 14,227,140 lekë pa TVSH, ofertë më e ulët se ajo e shpallur fituese, [REDAKTUAR], SHPK me ofertë 15,007,150 lekë pa TVSH. Referuar Vendimit të KPP për këtë procedurë, me nr. 953/3, datë 02.09.2013, me ankimues [REDAKTUAR] SHPK, vendimi i KVO për arsye të skualifikimit për shkak të paraqitjes së vërtetimit nga administrata tatimore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 (me gjithë ndryshimet), kreu III, pika 2/c, është rrëzuar dhe sipas të cilit [REDAKTUAR] SHPK është kualifikuar dhe është shpallur fitues. KVO ka skualifikuar OE [REDAKTUAR] SHPK për të njëjtën arsye për shkak të paraqitjes së vërtetimit nga administrata tatimore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 (me gjithë ndryshimet), kreu III, pika 2/c, e cila është rrëzuar nga KPP sa trajtuar më sipër, pasi vërtetimi i paraqitur nga të dy OE është i njëjtë dhe i lëshuar nga e njëjta DRT, ajo e Gjirokastrës. KVO duhej të kualifikonte dhe OE [REDAKTUAR] SHPK pas vendimit të KPP sa më sipër. Një arsye tjetër në sistem mbi skualifikimin e [REDAKTUAR] SHPK është dhe (Punë të ngjashme në objektin “Rikonstrukcion ujësjellësi Krahës” është paraqitur vetëm formulari i kontratës dhe jo kontrata si është kërkuar në DST). Kjo është vendosur padrejtësisht nga KVO pasi OE ka paraqitur në tender jo vetëm formularin e kontratës por edhe aktin e kolaudimit, situacionin përfundimtar, formularin e vlerësimit dhe procesverbalin e marrjes së objektit në dorëzim. Përsa trajtuar më sipër, KVO sipas të dhënave të tenderit rrjedhimisht Autoriteti Kontraktor, ka skualifikuar OE [REDAKTUAR] SHPK nga gara duke cenuar konkurrencën e drejtë në tender me impakt negativ financiar për buxhetin e ish-komunës në shumën **780,010 lekë** me pasojë mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve, të llogaritur si diferencë e vlerës të ofertës ekonomike të skualifikuar me atë të shpallur fituese.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Memaliaj nëpërmjet strukturave përkatëse, të analizojë procedurën e prokurimit të trajtuar në gjetje sa më sipër dhe të marrë masa për të parandaluar në të ardhmen në raste të ngjashme zbatimin e vendimeve të KPP vetëm për OE ankimues kur objekti i ankimimit është i njëjtë si precedent.

Në vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 i ndryshuar, Kreu III, nenin 15 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Memaliaj t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrës punimesh**, si më poshtë:

1- [REDAKTUAR], përfaqësues i [REDAKTUAR] shpk në masën **300,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a- “*Ansambli Arkitektonik i Sheshit Minatori Memaliaj*”, me sipërmarrës punimesh BOE [REDAKTUAR] shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **6,157,843 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej ndryshimit të zërave në situacion sipas jo sipas volumeve të punimeve të kryer në objekt;

2-Enver Behaj, përfaqësues i [REDAKTUAR] shpk në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a- “*Sistemim e asfaltim rruga Memaliaj Fshat, Bashkia Memaliaj*”, me sipërmarrës punimesh BOE [REDAKTUAR] shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **119,746 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt;

3- [REDAKTUAR], përfaqësues i [REDAKTUAR] shpk në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a- “*Rikonstrukcion rrugët e njësisve administrative të Bashkisë Memaliaj*”, me sipërmarrës punimesh OE [REDAKTUAR] shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **53,269 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt;

OPINIONI AUDITIMIT

Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun II të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e Bashkisë Memaliaj, për periudhën 2016-2017, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g) të Raportit Përfundimtar të Auditimit për sa i përket: Planifikimit dhe zbatimit të planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij, Programimit të PBA 2017-2019 dhe programimit të buxhetit të vitit 2016, 2017, Çeljes së fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet e tij gjatë vitit sipas Akteve Normative, saktësisë së realizimit të treguesve kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të institucionit dhe zbatimit të dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre si dhe plotësimin dhe raportimit të pasqyrave financiare.

Gjithashtu veprimtaria e Bashkisë Memaliaj përputhet me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për sa i përket zbatimit të kontratave për punë publike me përjashtim të kontratave nr. 718/8 prot. datë 03.10.2016 me objekt “*Rikonstrukcion rrugët e njësisve administrative të Bashkisë Memaliaj*”; nr. 642/11 prot. datë 31.08.2017 me objekt “*Sistemim e asfaltim rruga Memaliaj*”

Fshat, Bashkia Memaliaj” dhe nr. 314/38 dt.12.07.2016 me objekt “Ansamblu Arkitektonik i Sheshit Minatori Memaliaj” ku, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 6,330,858 lekë pa tvsh.

Shënim: Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R